

V E N D I M
Nr.439, datë 9.9.1999

**PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENCAT E KONVIKTEVE, PËR
BURSAT E SHTETIT DHE PËR PAGESAT E FAMILJEVE, PËR NXËNËSIT DHE
STUDENTËT DHE PËR FËMIJËT QË PRANOHEN NË SHTËPITË E FËMIJËS, NË
INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK DËGJOJNË E NUK SHIKOJNË DHE NË INSTITUTIN
E FËMIJËVE ME PRAPAMBETJE TË LEHTË MENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.8379, datë 9.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nxënësve dhe studentëve u jepet bursë ose gjysmëbursë çdo vit, brenda mundësive financiare që ka buxheti i shtetit, sipas parashikimit vjetor të planit të buxhetit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2. Burës ose gjysmëburse përfitojnë:

a) Nxënësit dhe studentët, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrave nr.1 dhe nr.2, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi, dhe që:

- në vendbanimin e tyre nuk kanë shkollë të mesme ose të larta të profilit;

- nuk kanë transport të siguruar brenda ditës, si dhe janë të detyruar të strehohen në konvikt.

b) Nxënësit, që banojnë në fshat, të cilët nuk kanë shkollë 8-vjeçare brenda rrezes prej 5 km dhe transport të siguruar e që vendosen në konvikt.

c) Nxënësve dhe studentëve, që njihen si jetimë dhe që përfitojnë të gjitha të drejtat që u jep ligji për jetimet, në të gjitha kategoritë e shkollave, u jepet bursë e plotë.

ç) Studentët bashkëshortë, që kanë fëmijë, përfitojnë secili bursë.

d) Nxënësit dhe studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë.

Nxënësit dhe studentët jetimë, studentët e shkurorëzuar, nxënësit dhe studentët e braktisur, që trjtohen me bursë ose gjysmëbursë, e përfitojnë atë dhe gjatë pushimeve tremujore dhe atyre verore. Bursa ose gjysmëbursa gjatë pushimeve të jepet nga institucioni arsimor përkatës, me lekë në dorë.

e) Studentët, që në vitin shkollor 1999-2000, fillojnë studimet në vitin e parë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në degët matematikë, fizikë, në Universitetin e Tiranës, si dhe ata studentë, që kanë përfituar bursë sipas këtij kriteri, të trajtohen me bursë, jashtë kriterit ekonomik, deri në përfundimin e studimeve.

Për këtë kategori studentësh, bursat do të shpërndahen nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës i Universitetit të Tiranës. Plani do të jepet nga MASH-i në bazë të pranimeve të reja të miratuara për këto degë nga Këshilli i Ministrave.

ë) Studentëve, që kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me të gjitha notat 10-ta, u jepet bursë e plotë, jashtë kriterit ekonomik.

Nxënësit e arsimit të mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës, me të gjitha notat 10-ta, përfitojnë të drejtën e bursës.

f) Nxënësve përsëritës që fitojnë klasën, studentëve që fitojnë provimet e kursit, si dhe atyre që nuk kanë përfituar bursë ose gjysmëbursë njëherësh me të drejtën e studimit dhe që gjatë vazhdimit të shkollës u kanë ndodhur ndryshime në gjendjen ekonomike, mund t'u jepet bursë ose gjysmëbursë nga bursat e ndërmjetme, nga vetë shkollat dhe, kur nuk ka mundësi të tilla, u jepet brenda planit të bursave të vitit të parë, me miratimin e këshillit të rrethit.

g) Pedagogët e punonjësit kërkimorë, të cilët kryejnë kualifikim shkencor, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.786, datë 17.12.1998, kjo kategori përfiton të gjitha të drejtat që gëzojnë studentët. Plani për këtë kategori bursistësh do të jetë jo më shumë se 10 bursa, brenda planit

të vitit të parë.

Shpërndarja e bursave të bëhet nga MASH-i.

3. Bursë dhe gjysmëbursë nuk përfitojnë:

a) Sipas pikës 2 shkronja “a” nxënësit dhe studentët e familjeve, të cilat ushtrojnë veprimtari private, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

b) Shteti do t’i vlerësojë studentët dhe nxënësit, e ndarë nga trangu familjar, për efekt të trajtimit me bursë, në bazë të të ardhurave ekonomike të të gjithë familjes, nga e cila është ndarë. Për efekt dokumentesh do të merret certifikata familjare para ndarjes.

c) Bursë ose gjysmëbursë nuk mund të fillojë më shumë se një person në familje, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 shkronjat “d” dhe “e” të këtij vendimi.

ç) Nxënësit e shkollave 8-vjeçare, të mesme dhe studentët që nuk fitojnë klasën.

d) Studentët, pavarësisht nga kriteret, nuk mund të përfitojnë bursë ose gjysmëbursë më tepër se vitet e shkollimit, të përcaktuara në planin mësimor për degën përkatëse.

4. Këshillat e disa rretheve, me propozimin e komunave e të bashkive, kanë të drejtë të miratojnë bursë ose gjysmëbursë, jashtë kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, brenda planit të vitit të parë: në rrethet Berat, Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkodër deri në 4 bursa, bashkia e Tiranës deri në 20 bursa, kurse rrethet e tjera deri në 3 bursa.

Nxënësit dhe studentët, që përfitojnë bursë sipas pikës 4 të këtij vendimi, e përfitojnë atë gjatë gjithë viteve të planifikuara të shkollimit.

5. Bursistët jetimë të shtëpive të fëmijës dhe jetimët e shkollave të mesme e të larta, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe nuk Shikojnë, si dhe emigrantët politikë përfitojnë falas veshmbathje, libra, fletore, sipas normave të përcaktuara në natyrë, sipas pasqyrës nr.5, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kjo kategori nxënësish përfiton falas nga shteti shërbim mjekësor, në kuotën deri në 200 (dyqind) lekë në muaj për një nxënës, si dhe shërbim shëndetësor dentar të urgjencës.

Kuota e ushqimit dhe shpenzimet e vogla për nxënësit e institucioneve të arsimit të veçantë, me konvikt, të jetë sipas pasqyrës nr.5/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Fëmijët e institucioneve të arsimit të veçantë, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti me një vakt ushqimi (drekën) dhe me mjete shkollore. Kuota ushqimore për këtë kategori nxënësish të jetë 70 (shtatëdhjetë) lekë në ditë.

Për të qenë më pranë fëmijëve dhe për t’i ndihmuar ata sa më mirë, mësuesit dhe edukatorët e institucioneve të mësipërme gëzojnë të drejtën të ushqehen një vakt (dreka), me vlerë deri në 50 (pesëdhjetë) lekë në ditë.

Kuota financiare ushqimore, ditore për studentin të jetë sipas pasqyrës nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Nxënësve dhe studentëve jetimë, bursistë, u jepen të holla, për nevoja vetjake, përkatësisht 500 (pesëqind) dhe 700 (shtatëqind) lekë në muaj. Këtë të drejtë e gëzojnë dhe kur shtrohen në institucione shëndetësore.

6. Niveli i bursave dhe i kuotave financiare të ushqimit, për të gjitha kategoritë e shkollave, të jetë sipas pasqyrave nr.3 dhe nr.4 “Për nivelin e bursave dhe të kuotave financiare, ditore”. Kuota ushqimore, në lekë, për nxënësit dhe studentët të jetë sipas pasqyrës nr.6 dhe kuota financiare në natyrë për ushqim të studentëve të jetë sipas pasqyrës nr.7, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Bursa e plotë dhe gjysmëbursa për studentët jepet me të holla në dorë.

Kur konviktet nuk funksionojnë, sipasojë e shkatërrimeve të vitit 1997, bursa, kësaj kategorie nxënësish, do t’u jepet me lekë në dorë.

7. Studenti dhe nxënësi, që përfiton bursë ose gjysmëbursë, nuk përfiton kompensim ushqimor.

8. Nxënësve dhe studentëve, që humbasin vitin shkollor për arsye shëndetësore ose fatkeqësi familjare etj., u ruhet bursa.

9. Kur institucioni arsimor kryen zyrtarisht transferimin e së drejtës të studimit, bashkë me të transferon edhe planin e bursës, që ka gëzuar studenti.

Transferimi i bursës së nxënësit të bëhet me miratimin e drejtorisë ekonomike, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Bursat dhe gjysmëbursat për vitet e para të shkollës 8-vjeçare, të mesme dhe të lartë, miratohen nga bashkia ose komuna, ku ka vendbanimin e përhershëm nxënësi apo studenti.

10. Bursat ose gjysmëbursat për nxënësit dhe studentët e të gjitha niveleve, për vitet e para, vërtetohen, për efekt plani, edhe nga drejtoritë arsimore të rretheve, në përputhje me planin e dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Drejtoritë arsimore në rrethe bëjnë shpërndarjen e planit të bursave, duke përfshirë edhe bursat, që miratohen nga këshilli i rrethit, brenda planit të vitit të parë.

Bursat ose gjysmëbursat për nxënësit dhe studentët e viteve të dyta e lart rishqyrtohen e miratohen nga vetë shkollat dhe fakultetet ose nga institucionet përkatëse.

11. Të drejtat që fëmijët, nxënësit dhe studentët përfitojnë sipas këtij vendimi, fillojnë nga data e fillimit të vitit të ri shkollor. Në periudhën e pushimeve verore, nxënësit dhe studentët nuk përfitojnë bursë ose gjysmëbursë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë vendim.

12. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për vitin shkollor 1999-2000, i jepen 1200 bursa për arsimin e lartë dhe 900 bursa për arsimin e mesëm.

13. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga viti i dytë e lart, për të gjitha kategoritë e shkollave, është data 30 tetor 1999.

14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave të vitit të parë, për të gjitha kategoritë e shkollave, është data 30 nëntor 1999.

Çdo shqyrtim dhe miratim jashtë këtij afati përbën shkelje të disiplinës financiare, si për organin miratues, ashtu dhe për atë pranues.

15. Kuotat financiare të ushqimit në menca rriten nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, nga Ministria e Financave dhe nga Ministria e Pushtetit Lokal, në varësi të indeksit të çmimeve të konsumit.

16. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

17. Të gjitha vendimet dhe udhëzimet për bursën, kuotën ushqimore, për veshmbathje dhe të tjera shpenzime, për studentët, nxënësit, nxënësit e arsimit të veçantë dhe jetimet, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko